

19  
17/02



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## KËSHILLI QARKUT SHKODËR

### KRYETARI

### V E N D I M

Nr. 10 Datë 05.08.2020


### “MBI MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2021-2023, PËR KËSHILLIN E QARKUT SHKODËR”


Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 05.08.2020, pasi dëgjoji materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër “Mbi miratimin e Tavanëve Përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” neni 76, neni 77 pika dh) dhe pika n) neni 78 pika 1 dhe pika 3. Ligjit nr.68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes Vendore”, nenin 37. Udhëzimit plotësues Nr.27, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023”, shkresës nr 13034/1, datë 10.07.2020, protokolluar me nr. 315, datë 16.07.2020. Neni 12,13,15 i “Rregullores për organizimin dhe Funkionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër”. Aktin Normativ Nr.03 date 15.03.2020 konkretisht neni 5, për vendimarrjen e organeve kolegjiale gjatë gjendjes së infeksionit Covid-19.

Duke marrë shkas nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, mbledhja e rradhës e Këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua online nëpërmjet platformës Zoom, pas diskutimit nga anëtarët në perfundim të procesit të votimit i cili u realizua i hapur, Miratohet me 14 vota pro, 0 kundra 0 abstenim.

### V E N D O S I :

1. Të miratojë Tavanet Përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, për çdo program.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## KËSHILLI QARKUT SHKODËR

### DREJTORIA E FINANCËS & BUXHETIT

Shkodër me 05.08.2020

### RELACION

#### **“Mbi miratimin tavanëve Përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, për Këshillin e Qarkut Shkodër”**

Në zbatim të Udhëzimit plotësues Nr.27, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023”, shkresës nr 13034/1, datë 10.07.2020” dërgohet udhëzimi plotësues Për përgatitjen e PBA-së 2021-2023”, protokolluar me nr. 315, datë 16.07.2020, bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave, kemi përgatitur dhe po paraqesim për miratim tavanet përfundimtare të shpenzimeve për Programin Afatmesëm Vendor 2021-2023, në nivel programi.

Raporti i vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve përmban të dhëna ;

- a) Dy vitet para vitit buxhetor dhe konkretisht fakti i vitit 2018 dhe 2019.
- b) Vitin buxhetor 2020,
- c) Tre vitet e ardhshme buxhetore dhe konkretisht për vitin 2021, 2022 dhe 2023 ku janë përcaktuar tavanet e shpenzimeve duke u nisur nga vlera absolute e miratuar në udhëzimin e lartpërmendur për shumën e transfertës së pakushtëzuar për vitet respektive buxhetore.

#### *Metodologjia e përdorur për parashikimet e të ardhurave*

Duke u nisur nga kuadri ligjor, të ardhurat që Këshillat e Qarqeve mund të arkëtojnë, janë tarifatat për shërbimet që kryhen për konfirmime hartash, nxjerrje dokumentash arshivore dhe tarifa për shërbime të kryera nga funksioni i deleguar DAMT.

Parashikimet e këtyre të ardhurave janë bërë bazuar në të ardhurat fatike të vitit të fundit kalendarik dhe në krijimin e mundësive për rritjen e tyre, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.



Kuadri Makroekonomik e fiskal për periudhën 2021-2023, i miratuar me VKM nr.53.datë 29.01.2020, për Këshillat e Qarqeve, si njësi e nivelit të dytë të qeverisjes vendore, është shumë i kufizuar.

Kuotat e antarësisë së bashkive përbërëse të Qarkut Shkodër, megjithëse zenë pjesën më të madhe të të ardhurave totale të KQSh, meqënëse vendoset nga bashkitë me vendim të Këshillit Bashkiak, janë vendosur duke parë tendencën e viteve të fundit dhe të ardhurat faktike nga kuota e antarësisë pasi megjithëse kjo kuote planifikohet në buxhetet e bashkive, nuk mbledhen të ardhurat nga bashkitë dhe si pasojë nuk bëhen veprimet ekonomike për transferoherimin e saj pranë KQSH.

Sic shihet në tabelën që përmban të dhënat për parashikimet afatmesme të të ardhurave për vitin 2018 fakti i të ardhurave nga kuota e antarësisë ka qenë 10,000 mijë lekë, të ardhura këto të planifikuara nga Bashkia Shkodër dhe dhenë më miratim keshilli me destinacion KQShkodër.

Planifikimi i kuotës së antarësisë nga bashkitë e qarkut Shkodër, për vitin 2019 është në masën 2,840 mijë lekë ose 80% më i ulët se në vitin 2018 dhe i realizuar 7% e planifikimit.

Planifikimi i kuotës së antarësisë nga bashkitë e qarkut Shkodër, për vitin 2020 është bërë bazuar në VKB-të e Bashkive të qarkut Shkodër dhe konkretisht shuma 2,140 mijë lekë.

Planifikimi i kuotës së antarësisë nga bashkitë e qarkut Shkodër, për vitet 2021-2023 është bërë bazuar në planifikimin e vitit 2020 e në krahasim me tavanet përgatitore, duke konsideruar situatën e krijuar nga pandemia Covid 19, të atdhurat nga kuota e antarësisë së qarkut janë zbritur nga 2500 mijë lekë që ishin planifikuar, në 2000 mijë lekë për çdo vit buxhetor.

#### *a) Analiza e efekteve të politikave fiskale .*

Këshilli i Qarkut Shkodër, bazuar në llojin e të ardhurave që mund të arkëtojnë siç janë tarifatat për shërbimet që kryhen për konfirmime hartash, nxjerrje dokumentash arshivore dhe tarifa për shërbime të kryera nga funksioni i deleguar DAMT, politikën e reja fiskale, nuk kanë dhënë efekt tek tarifatat e planifikuara të të ardhurave.

Në tabelën PERMBLEDHESE E TE ARDHURAVE, paraqiten të ardhurat e planifikuara sipas llojit të tyre për vitin buxhetor, faktin e të ardhurave për dy vitet e mëparshme buxhetore dhe 3 vitet e ardhshme buxhetore, 2021-2023.

#### *b) Analiza e rrisqeve dhe masat për përballimin e tyre.*

Nisur nga kuadri ligjor i të ardhurave, KQShkodër bën planifikimin e tyre në mënyrë të tillë që të mos ketë efekt negativ në përmbushjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të cilat janë të sanksionuara në ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”

Pesha specifike e të ardhurave të planifikuara dhe të realizuara në raport me të ardhurat totale nga burimet e tjera për Kqshkodër është shumë e vogël.

Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të miratuara si dhe në transfertat e pakushtëzuara të përcaktuara në vlerë absolute në Udhëzimin nr.27, datë 10.07.2020 të Ministrisë së Financave, i protokolluar në institucionin tonë me nr.315, datë 16.07.2020, janë përgatitur dhe i paraqesim për miratim tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA-në 2021-2023 në nivel programi.

Programet për të cilat do të planifikohen shpenzimet buxhetore për tre vitet e ardhshme 2021-2023 sipas IPF, do të jenë;

1. **1-Programi Organet Ekzekutive dhe Legjislative (Planifikim, menaxhim, administrim).**  
Progr.1a- Programi 01110  
  
Progr.1e- Programi 01160, DAMT, funksion i deleguar
2. **8- Programi Rrjeti Rrugor**  
Progr. 8a- Programi 04520
3. **9- Programi Zhvillimi i Turizmit**  
Progr. 9b- Programi 04760
4. **16- Programi Furnizimi me uje**  
Progr.16 a Programi 06330
5. **26- Programi Përfshirje sociale**  
Progr.26b Programi 10460

Ne tabelen e bashkangjitur të tavanëve të PBA-së 2021-2023, janë pasqyrur limitet e shpenzimeve të ndara sipas programeve buxhetore sipas IPF.

Edhe në vendosjen e tavanëve përgatitore të shpenzimeve sipas programeve vazhdojnë të mbeten prioritetet investimet e nisur për rrjetin ujësjellës dhe Rikonstrukcioni i Rrugës Bardhaj-Rrenc si dhe investimet për të cilat do të propozohen nga anëtarët e Këshillit të Qarkut dhe Kryetarët e Bashkive të qarkut Shkodër sipas prioritetëve të vendosura dhe të miratuara në KB-të respektive.

Në vitin Buxhetor 2020, Ministria e Shëndetësisë, ka akorduar fonde në shumë 2,468 mijë lekë për shtëpi familje Facibeni. Meqë kjo është Transferte e Kushtëzuar dhe ky është viti i parë që na akordohen fonde për këtë shtëpi familje, për 3 vitet e ardhshme nuk kemi bërë planifikim në këtë program.

Në ndryshim nga transferta e planifikuara në udhëzimin plotësues nr.10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023" dhe miratuar me vendimin e Këshillit të Qarkut shkodër nr.8, datë 26.03.2020 "Për miratimin e tavanëve përgatitore të PBA-së 2021-2023 e raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave", në këtë Udhëzim ka ndryshuar shumën e Transfertës së Pakushtëzuar e planifikuara për KQShkodër sipas viteve dhe përkatsisht;

Transferta e vitit 2021 ka qenë planifikuara 61,709 mijë lekë, bëhet 56,566 mijë lekë,

Transferta e vitit 2022 ka qenë planifikuara 66,851 mijë lekë, bëhet 61,708 mijë lekë,

Transferta e vitit 2023 ka qenë planifikuara 68,908 mijë lekë, bëhet 64,794 mijë lekë

Pra siç shihet ka nja zbritje afersisht 8% dhe 6 % sipas viteve.

Analiza sipas Programeve;

**1- Programi Organet Ekzekutive dhe Legjislative (Planifikim, menaxhim, administrim).**  
**Progr.1a- Programi 01110**

Ky program përfshin **Pragramin 1a** (01110), planifikimin, menaxhimin e administrim për administratën e institucionit tone, për të mundësuar përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Në këtë program, siç shifet në tabelën e tavaneve, përfshihen shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore për vitin respektiv 2020 si dhe për 3 vitet e ardhshme 2021-2023.

Në shpenzimet korrente, pasqyrohen tavanet e shpenzimeve për shpenzimet operative, art.602, transfertat e brendshme, ato sipas VKM-ve dhe sipas VKQ-se, art.604, shpenzimet për transfertat e jashtme art. 605 si dhe transfertat për individet art.606. Dhe këto janë të pasqyruara për vitin buxhetor 2020 si dhe për 3 vitet e ardhshme 2021-2023.

Në shpenzimet kapitale të këtij Programi, për vitin 2020, janë pasqyruar vlera 200 mijë lekë e planifikuar për paisje e orendi zyre dhe vlera 2,140 mijë leka e planifikuar për investimin "Varrezat publike të qytetit Pukë".

Të ardhurat e planifikuara nga kuotat vjetore të qarkut në këtë program, të cilat janë rreth 2,000 mijë lekë për secilin vit buxhetor, janë planifikuar për këtë investim dhe pjesa tjetër për paisje zyrash.

#### **Progr.1e- Programi 01160, DAMT, funksion i deleguar**

**Pragramin 1e** (01160), planifikimin, menaxhimin e administrim për DAMT, funksion i deleguar pranë institucionit tone, për të cilin akordohen fondet nga Ministria e Brendshme me transfertë të kushtëzuar, të detajuara për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative për 6 punonjësit e kësaj strukture.

#### **2. 8- Programi Rrjeti Rrugor** **Progr. 8a- Programi 04520**

Në tabelën e tavaneve, për këtë program, janë pasqyruar investimet e planifikuara në buxhetin e vitit 2020 si dhe një shumë e planifikuar për vitin 2023, meqë prioritet i është dhënë investimit të Ujësjellësit të Muriqanit, Bashkia Shkodër.

#### **3. 9- Programi Zhvillimi i Turizmit** **Progr. 9b- Programi 04760**

Meqë në vitin aktual kemi planifikuar fonde për një projekt që kemi në fushën e turizmit, i cili përfundon në fund të këtij viti dhe në institucion kemi aplikuar në disa projekte kryesisht në fushën e turizmit, kemi planifikuar fonde për 3 vitet e ardhshme, për bashkëfinancime apo mbulim kosto tvsh-je, kusht për vazhdimësinë e tyre, po në këtë fushë.

#### **4. 16- Programi Furnizimi me uje** **Progr.16 a Programi 06330**


Në buxhetin e vitit 2020, kemi planifikuar fonde për investimin "Ndërtim i ujësjellësit Muriqan" në vlerën 18,900 mijë lekë. Në këtë vit buxhetor, është hartuar projekti i këtij investimi në vlerën totale 98,181 mijë lekë. Siç shihet, me vlerën e planifikuar të këtij viti, ne realizojmë rreth 20% të vlerës së projektit. Prandaj meqë për KQShkodër, mbetet prioritet ky investim, kemi bërë shpërndarjen e fondeve sipas 3 viteve të ardhshme buxhetore 2021-2023 dhe me fondet që janë planifikuar për institucionin tonë, ky investim do të përfundojë në vitin 2023.

**5. 26- Programi Përfshirje sociale  
Progr.26 b Programi 10460**

Në vitin Buxhetor 2020, Ministria e Shëndetësisë, ka akorduar fonde në shumë 2,468 mijë lekë për shtëpine familje Facibeni. Meqe kjo është Transferte e Kushtëzuar dhe ky është viti i parë që na akordohen fonde për këtë shtëpi familje, për 3 vitet e ardhshme nuk kemi bërë planifikim në këtë program.

**NEPUNESI ZBATUES**

**Gjyljana MIRUKU**



e PBA - 2021-2023

|   |           |         |
|---|-----------|---------|
| Emri i Shpenzimeve të Programit                         | 2021-2023 | TAVANET |
| Tavanet e PBA për institucionin dhe Tavanet e Programit |           |         |
| KESHILLI I QARKUT SHKODER                               |           |         |
| Emri i Entit:   |           |         |
| Emri i Grupit:  |           |         |
| Mijë Lekë   |           |         |

| Tavani i Institucionit | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | Buxheti  |                 |                 |                 |
|------------------------|-------------------|------------------|----------|-----------------|-----------------|-----------------|
|                        |                   |                  | 2020     | 2021            | 2022            | 2023            |
| TOTALI                 | Paga              | 600-601          | 22,740.0 | 22,740.0        | 22,740.0        | 22,740.0        |
|                        | Korente të tjera  | 602-606          | 24,198.0 | 14,275.0        | 14,375.0        | 14,375.0        |
|                        | Kapitale          | 230-231          | 43,302.0 | 27,436.0        | 32,478.0        | 35,564.0        |
|                        | Jashtë-buxhetore  |                  |          |                 |                 |                 |
|                        | <b>Totali</b>     |                  |          | <b>90,240.0</b> | <b>64,451.0</b> | <b>69,593.0</b> |

| Alokimi i Tavanit për Programet |                   |                  | Buxheti  |                 |                 |                 |
|---------------------------------|-------------------|------------------|----------|-----------------|-----------------|-----------------|
| Emertimi i Programit            | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2020     | 2021            | 2022            | 2023            |
| Administrata KQ Shkoder         | Paga              | 600-601          | 17,500.0 | 17,500.0        | 17,500.0        | 17,500.0        |
|                                 | Korente të tjera  | 602-606          | 17,426.0 | 12,730.0        | 12,830.0        | 12,830.0        |
|                                 | Kapitale          | 230-231          | 2,340.0  | 2,200.0         | 2,300.0         | 2,300.0         |
|                                 | Jashtë-buxhetore  |                  |          |                 |                 |                 |
|                                 | <b>Totali</b>     |                  |          | <b>37,266.0</b> | <b>32,430.0</b> | <b>32,630.0</b> |

| Alokimi i Tavanit për Programet |                   |                  | Buxheti |                |                |                |
|---------------------------------|-------------------|------------------|---------|----------------|----------------|----------------|
| Emertimi i Programit            | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2020    | 2021           | 2022           | 2023           |
| Turizmi                         | Paga              | 600-601          |         | 1,200.0        | 1,200.0        | 1,200.0        |
|                                 | Korente të tjera  | 602-606          | 3,959.0 |                |                |                |
|                                 | Kapitale          | 230-231          | 2,800.0 |                |                |                |
|                                 | Jashtë-buxhetore  |                  |         |                |                |                |
|                                 | <b>Totali</b>     |                  |         | <b>6,759.0</b> | <b>1,200.0</b> | <b>1,200.0</b> |


| Alokimi i Tavanit për Programet |                   |                  | Buxheti  |                 |            |            |
|---------------------------------|-------------------|------------------|----------|-----------------|------------|------------|
| Emertimi i Programit            | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2020     | 2021            | 2022       | 2023       |
| Investime rugore                | Paga              | 600-601          |          |                 |            |            |
|                                 | Korente të tjera  | 602-606          | 19,262.0 |                 |            | 9,397.0    |
|                                 | Kapitale          | 230-231          |          |                 |            |            |
|                                 | Jashtë-buxhetore  |                  |          | 0.0             | 0.0        | 9,397.0    |
|                                 | <b>Totali</b>     |                  |          | <b>19,262.0</b> | <b>0.0</b> | <b>0.0</b> |

| Alokimi i Tavanit për Programet |                   |                  | Buxheti  |                 |                 |                 |
|---------------------------------|-------------------|------------------|----------|-----------------|-----------------|-----------------|
| Emertimi i Programit            | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2020     | 2021            | 2022            | 2023            |
| Ujesjellesi                     | Paga              | 600-601          |          |                 |                 |                 |
|                                 | Korente të tjera  | 602-606          | 18,900.0 | 25,236.0        | 30,178.0        | 23,867.0        |
|                                 | Kapitale          | 230-231          |          |                 |                 |                 |
|                                 | Jashtë-buxhetore  |                  |          |                 |                 |                 |
|                                 | <b>Totali</b>     |                  |          | <b>18,900.0</b> | <b>25,236.0</b> | <b>30,178.0</b> |

| Alokimi i Tavanit për Programet |                   |                  | Buxheti |                |                |                |
|---------------------------------|-------------------|------------------|---------|----------------|----------------|----------------|
| Emertimi i Programit            | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2020    | 2021           | 2022           | 2023           |
| DAMT                            | Paga              | 600-601          | 5,240.0 | 5,240.0        | 5,240.0        | 5,240.0        |
|                                 | Korente të tjera  | 602-606          | 345.0   | 345.0          | 345.0          | 345.0          |
|                                 | Kapitale          | 230-231          |         |                |                |                |
|                                 | Jashtë-buxhetore  |                  |         |                |                |                |
|                                 | <b>Totali</b>     |                  |         | <b>5,585.0</b> | <b>5,585.0</b> | <b>5,585.0</b> |

| Alokimi i Tavanit për Programet |                   |                  | Buxheti |                |            |            |
|---------------------------------|-------------------|------------------|---------|----------------|------------|------------|
| Emertimi i Programit            | Emri i Artikullit | Nr. i Artikullit | 2020    | 2021           | 2022       | 2023       |
| Ministria e Shëndetsise         | Paga              | 600-601          |         |                |            |            |
|                                 | Korente të tjera  | 602-606          | 2,468.0 | 0.0            | 0.0        | 0.0        |
|                                 | Kapitale          | 230-231          |         |                |            |            |
|                                 | Jashtë-buxhetore  |                  |         |                |            |            |
|                                 | <b>Totali</b>     |                  |         | <b>2,468.0</b> | <b>0.0</b> | <b>0.0</b> |

|             |                  |                     |
|-------------|------------------|---------------------|
| Miratimi    | Nepunesi Zbatues | Nepunesi Autorizues |
| Emri:       |                  | Emri:               |
| Nënshkrimi: |                  | Nënshkrimi:         |
| Data:       |                  | Data:               |



*[Handwritten signature]*

KESHILLI QARKUT SHKODER  
PERMBLEDHESHE E TE ARDHURAVE

000/leke

| Nr | Emertimi i të Ardhurave Tatimore                   | Fakti 2018 | Fakti per vitin 2019 | Buxheti per vitin 2020 | Buxheti per vitin 2021 | Buxheti per vitin 2022 | Buxheti per vitin 2023 |
|----|--|------------|----------------------|------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|
| A  | Të ardhura   |            |                      |                        |                        |                        |                        |
| I  | Të ardhura nga tarifat                             | 152        | 84                   | 300                    | 300                    | 300                    | 300                    |
| a  | Tarifa për konfirmim hartash                       | 36         | 14                   | 100                    | 100                    | 100                    | 100                    |
| b  | Tarifa për shërbime administrative(dok. Arshivore) | 18         | 16                   | 100                    | 100                    | 100                    | 100                    |
| c  | Tarifa shërbim Kadastral                           | 99         | 55                   | 100                    | 100                    | 100                    | 100                    |
| d  | Tarifa shërbim Transp.                             | 0          | 0                    | 0                      | 0                      | 0                      | 0                      |
| II | Të ardhura te ndryshme                             | 10,000     | 200                  | 2,140                  | 2,000                  | 2,000                  | 2,000                  |
| a  | Te ardhurat nga kuota vjetore e bashkive           | 10,000     | 200                  | 2,140                  | 2,000                  | 2,000                  | 2,000                  |
| A  | Totali i te ardhurave te veta (I+II)               | 10,152     | 284                  | 2,440                  | 2,300                  | 2,300                  | 2,300                  |
| B  | Transferta e pakushtezuar                          | 43,850     | 43,801               | 56,661                 | 56,566                 | 61,708                 | 64,794                 |
| E  | Te trasheguara                                     | 40,123     | 28,751               | 20,286                 | 0                      | 0                      | 0                      |
| C  | Transferta e kushtezuar DAMT                       | 5,154      | 5,531                | 5,585                  | 5,585                  | 5,585                  | 5,585                  |
| CI | Transferta e kushtezuar Shtepia FACIBENI           | 0          | 0                    | 2,468                  |                        |                        |                        |
| D  | Financime te huaja                                 | 0          | 0                    | 2,800                  | 0                      | 0                      | 0                      |
|    | ADRIATICAVES (Thesari)                             | 0          | 0                    | 2,800                  | 0                      | 0                      | 0                      |
|    | ADRIATICAVES (Banka nivelit dyte)                  | 1,899      | 783                  | 0                      | 0                      | 0                      | 0                      |
|    | Totali I te ardhurave (2021-2023)                  | 99,127     | 78,083               | 90,240                 | 64,451                 | 69,593                 | 72,679                 |

Nëpunësi Zbatues

Gjyljana MIRUKU

